

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës:

PN 554/14

PP 376/12 Gjykata Themelore e Prizrenit

Më:

10 shkurt 2015

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti, kryetar dhe gjyqtar raportues i kolegjit, gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Abdullah Ahmeti, si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Kirsten Moyes, si procesmbajtëse në lëndën penale nr. PP 376/12, e cila është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit kundër:

FH, NU, SM, MHB, KH, KHU, HM, NHM, IHC

Të akuzuar për

(Pika 1) Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me nenin 346 të ish Kodit Penal të Kosovës (KPK), aktualisht e sanksionuar me nenin 432 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK); për **SM**;

(Pika 2) Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, paragrafët 1, 2 dhe 3 lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 422, paragrafët 1 dhe 5, lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **NU, SM dhe FH**;

(Pika 3) Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 334, paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 403, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH dhe KHU**;

(Pika 4) Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 334, paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 403, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH, KHU, MHB, NHM, HM dhe IHC**;

(Pika 5) Mashtrimi, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 261, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 335, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **NU, FH dhe SM**;

(Pika 6) Mashtrimi, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 261, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me

nenin 335, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH** dhe **KHU**;

(Pika 7) Mashtrimi, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 261, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 335, paragrafin 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH, KHU, MHB, NHM, HM** dhe **IHC**;

(Pika 8) Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 259, paragrafi 1 dhe lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 332, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH** dhe **KHU**;

(Pika 9) Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 259, paragrafi 1 dhe lidhur me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 332, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH, KHU, MHB, NHM, HM** dhe **IHC**;

(Pika 10) Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 332, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së; për **KH, KHU, MHB, NHM, HM** dhe **IHC**;

(Pika 11) Krimi i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafët 1 dhe 2 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 283, paragrafi 1 të KPRK-së; për **NU, SM, FH, KH, KHU, MHB, NHB, HM** dhe **IHC**;

(Pika 12) Krimi i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 3 të ish KPK-së, aktualisht e sanksionuar me nenin 283, paragrafi 2 të KPRK-së; për **NU**;

Objekti i aktvendimit të Gjykatës së Apelit

Ndaj aktvendimit të kryetarit të trupit gjykues PN 554/14, të datës 21 gusht 2014, mbi kundërshtimin e provave dhe kërkesave për ta hedhur poshtë aktakuzën, nga mbrojtësit janë ushtruar këto ankesa:

- ankesa e parashtruar më 25 shtator 2014 nga mbrojtësi Visar Vehapi, në emër të të pandehurës **SM**;
- ankesa e parashtruar më 15 shtator 2014 dhe 8 tetor 2014 nga mbrojtësi Selatin Ahmeti, në emër të të pandehurit **FH**;

- ankesa e parashtruar më 12 shtator 2014 nga mbrojtësi Tahir Rrecaj, në emër të të pandehurit **NU** ndaj aktvendimit të datës 21 gusht 2014. Një ‘plotësim’ i ankesës ishte parashtruar më 24 tetor 2014;
- ankesa e parashtruar më 12 shtator 2014 nga mbrojtësi Zivojin Jokanovic, në emër të të pandehurës **MHB**;
- ankesa e përbashkët e parashtruar më 12 shtator 2014 nga mbrojtësit Xhevat Bici, Haxhi Kelmendi, Bajram Tmava, Qerim Metaj, Qazim Qerimi dhe Selman Bogiqi, në emër të të pandehurave **MHB, KH, KHU, HM, NHM** dhe **IHC** (‘motrat’).
- kërkesa e motrave, e datës 24 nëntor 2014, e emëruar si ‘kërkesë për heqjen e ndalesës për tërheqje të parave nga xhirollogaritë bankare’, ishte drejtuar tek Gjykata e Apelit.

pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit të PSRK-së, e parashtruar më 24 tetor 2014, dhe përgjigjes së prokurorit të apelit të shtetit e paraqitur më 6 nëntor 2014;

duke vepruar në përputhje me nenin 413 dhe nenin 416 (1), (2) dhe (4) të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

pas këshillimit dhe votimit më 10 shkurt 2015;

kolegji i Gjykatës së Apelit merr këtë:

AKTVENDIM MBI ANKESËN

1. Refuzohen si të pabaza ankesat e mbrojtësit Visar Vehapi, e parashtruar më 25 shtator 2014, në emër të të pandehurës SM, mbrojtësit Selatin Ahmeti, e parashtruar më 15 shtator 2014, në emër të të pandehurit FH, mbrojtësit Tahir Rrecaj e parashtruar, më 12 shtator 2014, në emër të të pandehurit NU, mbrojtësit Zivojin Jokanovic, e parashtruar më 12 shtator 2014, në emër të të pandehurës MHB, dhe ankesa e përbashkët e parashtruar më 12 shtator 2014, nga mbrojtësit Xhevat Bici, Haxhi Kelmendi, Bajram Tmava, Qerim Metaj, Qazim Qerimi dhe Selman Bogiqi, në emër të të pandehurave MHB, KH, KHU, HM, NHM dhe IBC.

2. Hedhen poshtë si të paafatshme ankesa e dytë nga mbrojtësi Selatin Ahmeti, në emër të të pandehurit FH, e parashtruar më 8 tetor 2014 dhe ‘plotësimi në ankesë’ i parashtruar më 24 tetor 2014 nga mbrojtësi Tahir Rrecaj, në emër të të pandehurit NU.

3. **Hedhet poshtë si e palejueshme** kërkesa e motrave për heqjen e ndalimit për tërheqje të parave nga xhirollogaritë bankare.

4. **Vërtetohet aktvendimi** i kundërshtuar i kryetarit të trupit gjykues PN 554/14, i datës 21 gusht 2014.

ARSYETIMI

I Historiku përkatës i procedurës

1. Më 16 prill 2010 në këtë lëndë hetimi ka filluar me një letër mirëbesimi. Më 29 tetor 2010, është lëshuar një letër e dytë mirëbesimi. Më 10 tetor 2012, prokuroria ka nxjerrë aktvendimin mbi inicimin e hetimit ndaj **FH**. Hetimi ishte zgjeruar më 29 nëntor 2012, kundër **SM** dhe **NU** (dhe **NK**). Më tej hetimi ishte zgjeruar edhe më 30 maj 2013 kundër **MHB, KH, KHU, HM, NHM** dhe **IHC**.

2. Më 15 janar 2014, ishte ngritur aktakuza PP 376/12 kundër të pandehurve të përmendur më sipër. Aktakuza e ndryshuar ishte ngritur më 29 prill 2014, me të cilën u korrigjuan gabimet teknike dhe u futen dy kapituj të rinj që kanë të bëjnë me hetimet pas aktakuzës dhe pasuritë të cilat u nënshtrohen konfiskimit. Shqyrtimit fillestar ishte mbajtur më 20 maj 2014 dhe të pandehurit nuk e pranuan fajësinë për asnjë pikë të aktakuzës.

3. Më 19 qershor 2014, mbrojtësit e **NU, FH, SM** dhe të motrave kanë parashtruar kundërshtim ndaj provave dhe kanë kërkuar hedhjen poshtë të aktakuzës. Prokurori ka parashtruar përgjigje me shkrim.

4. Kryetari i trupit gjykues ka lëshuar aktvendimin e kundërshtuar të datës 21 gusht 2014, me të cilin ka refuzuar të gjitha kundërshtimet në prova si të pabaza dhe të gjitha provat e parashtruar nga prokurori bashkë me shkresat e lëndës i ka shpallur të pranueshme. Me anë të aktvendimit u refuzuan edhe të gjitha kërkesat për ta hedhur poshtë aktakuzën.

II Parashtruesat e palëve

a) Motrat

5. Një ankesë e përbashkët ishte parashtruar në emër të motrave, me të cilën propozohej hedhja poshtë e aktakuzës dhe ndërprerja e procedurës penale. Ato kanë paraqitur me sa vijon:

Kundërshtimet ndaj provave

- Aktvendimi cenon nenin 370 (6) dhe (7) të KPP-së sepse nuk ofron arsye për secilën pikë individuale mbi kundërshtimin e aktakuzës.

- Është e gabueshme që kryetari i trupit gjykues të pohoj se nuk është e duhur të definohet se cili kod i procedurës është më i favorshëm për të pandehurit në këtë fazë të procedurës pasi që kjo e përcakton nëse afati i parashkrimit përjashton përgjegjësinë penale.

- Disa dëshmi dhe prova janë të papranueshme sipas nenit 159 të KPP-së sepse ato janë siguruar pas ngritjes së aktakuzës. Mbrojtësit nuk pajtohen me interpretimin e neneve 228, 329 (3) dhe 244 (3) të KPP-së nga kryetari i trupit gjykues mbi këtë pikë. Pas ngritjes së aktakuzës të gjitha kompetencat i kalojnë gjykatës dhe prokurori medoemos duhet të paraqes kërkesë tek kryetari i trupit gjykues për të mbledhur prova të tjera.

- Hetimet nuk ishin kryer brenda 2 vjetësh sipas nenit 159 të KPP-së.

- Lidhur me veprën penale të krimit të organizuar, prokurori nuk i ka zgjeruar hetimet ekzistuese apo nuk ka iniciuar hetime të reja për të përfshirë këtë veprë penale, në kundërshtim me nenin 274 (3) dhe 103 (4) të KPP-së. Ka pasur edhe shkelje të neneve 123, 125, 131 dhe 132 të KPP-së pasi që të pandehurve nuk u është dhënë mundësia për tu mbrojtur për këtë veprë penale sepse ata nuk ishin marrë në pyetje lidhur me të.

Hedhja poshtë e aktakuzës

- Mbrojtësit nuk pajtohen me kryetarin e trupit gjykues për interpretimin e tij të kushtit minimal të burgimit për veprën bazë të veprës penale të krimit të organizuar. Për arsye se nuk ka asnjë vendim nga gjykata e shkallës së dytë mbi këtë çështje, përkufizimi i veprës penale duhet të interpretohet në të mirë të të pandehurve.

- Nuk ka prova se të pandehurit kanë kryer veprat penale të pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme, të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë ose mashtrimit. Prandaj ata nuk mundë të akuzohen për krim të organizuar.

- Mbrojtësit nuk pajtohen me interpretimin e periudhës së afatit të parashkrimit nga kryetari i trupit gjykues. Pikat 8 dhe 9 të aktakuzës nuk ndërpriten nga pika 10. Më tej, të pandehurit janë në posedim të ligjshëm faktik të pronës që nga viti 1986.

- Mbrojtësit nuk pajtohen se akuzimi kumulative i të pandehurve mbështetet në baza ligjore. Pikat e aktakuzës nuk janë shumë të qarta dhe në realitet janë mjaft konfuze.

- Mbrojtësit pohojnë përsëri se një element i veprës penale të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë është dokument/e i falsifikuar. Për më tepër nuk ka prova për t'i mbështetur këto vepra penale dhe gjykata në mënyrë të gabueshme e ka vërtetuar gjendjen faktike duke nxjerrë

përfundimin se ekziston dyshimi i bazuar mirë.

- Gjithashtu gjykata ka gabuar në gjetjen e dyshimit të bazuar mirë për veprat penale pasi që nuk ka prova. Përveç kësaj, asnjëri nga të pandehurit apo dëshmitarët nuk ka deklaruar se ekziston një grup kriminal. Ankesa e përbashkët hyn në disa detaje në kontestimin e provave.

- Nuk ka prova për ta arsyetuar propozimin e prokurorit për konfiskimin e parcelës së tokës xhironlogarive bankare. Shtëpia e vjetër ishte blerë nga komuna e Prishtinës më 1993, dhe shtëpia e re ishte ndërtuar në mes të viteve 2003 dhe 2005 nga mjetet financiare të prindërve të tyre.

b) MHB

6. Mbrojtësi Zivojin Jokanovic paraqet se aktvendimi i kundërshtuar përmban shkelje substanciale të procedurës penale, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të kodit penal. Ai propozon që aktakuza të hedhet poshtë dhe paraqet se:

- Nuk ka prova se i pandehuri ka kryer ndonjë veprë penale.

- Prona ishte fituar nga i pandehuri në mënyrë të ligjshme. Mbrojtësi hyn në disa detaje lidhur me atë pse blerja dhe pushtimi i pronës është i ligjshëm.

- Afat i parashkrimit për pushtim të paautorizuar ka skaduar që moti.

- Një 'krim i rëndë' është një veprë penale e dënueshme me së paku 4 vjet burgim, në përputhje me nenin 274 (7) të KPK-së.

c) NU

7. Mbrojtësi Tahir Rrecaj paraqet se aktvendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me nenin 415 (1) pikat 1 dhe 2, dhe nenin 253 të KPP-së, dhe i njëjti propozon që aktakuza ndaj këtij të pandehuri të hedhet poshtë dhe që procedura penale ndaj tij të pushohet. Ai paraqet me sa vijon:

- Kryetari i trupit gjykues nuk është përgjigjur në secilin pohim të mbrojtjes dhe nuk ka arritur të jap arsye për ta refuzuar kërkesën e mbrojtjes për ta hedhur poshtë aktakuzën.

- Kryetari i trupit gjykues është dashur ta definojë se cili kod është i zbatueshëm, pasi që kjo e përcakton nëse afati i parashkrimit e përjashton përgjegjësinë penale.

- Kryetari i trupit gjykues gabimisht e ka interpretuar nenin 244 dhe nenin 159 të KPP-së lidhur me hetimet pas ngritjes së aktakuzës. Prokurori nuk ka të drejtë për të ndërmarrë veprime hetimore pas ngritjes së aktakuzës. Përveç kësaj hetimet doemos duhet të kryhen brenda dy (2) vjetësh.

- Prokurori e ka shkelur nenin 132 (6) të KPP-së, pasi që ai nuk e ka njoftuar të pandehurin dhe mbrojtësin lidhur me datën, kohën dhe vendin se ku duhet të merren deklaratat e dëshmitarëve.

- Për pikat 2 dhe 5 afat i parashkrimit është arritur dhe i njëjti është arritur para inicimit të hetimeve. Është e pasaktë se afati i parashkrimit ishte ‘ndërprerë’, dhe prandaj vepra penale e ka arritur afatin e parashkrimit.

- Cilësimet juridike janë të paqarta dhe konfuze. Nuk është e qartë se çfarë veprimi ka kryer secili i akuzuar.

- Prokurori i ka injoruar provat shfajësuese, dhe nuk ka asnjë provë për t’i mbështetur akuzat e dhëna në aktakuzë.

- Për veprën penale të mashtrimit gjithsesi duhet të ketë dëm material konkret gjë e cila nuk ka ndodhur në këtë lëndë.

- Prokurori nuk ka sjellë asnjë provë të ekzistimit të grupit të organizuar kriminal. Mbrojtësi jep shembull të asaj që ai i konsideron karakteristika të një grupi të organizuar kriminal dhe pohon se prokurori nuk i ka vërtetuara këto karakteristika. Për më tepër, familja kurrë nuk mund të cilësohet si organizatë kriminale dhe nëse kryejnë vepra penale në bashkëpunim atëherë ata janë përgjegjës vetëm si bashkëkryerës.

Sikurse është vënë në pah më sipër, mbrojtësi ka parashtruar edhe një ‘plotësim’ në ankesë i cili është i paafatshëm dhe për këtë arsye përmbajtja e tij nuk është përmbledhur këtu.

d) FH

8. Mbrojtësi Selatin Ahmeti ka parashtruar ankesë në afatin e paraparë. Ai pohon se ka pasur shkelje substanciale të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai propozon që aktakuza të hedhet poshtë ose që të priset aktvendimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Megjithatë, ankesa nuk përmban parashtrësia, vetëm atë se do të pasojë arsyetimi. Sikurse u theksua më lart, edhe një ankesë e dytë ishte parashtruar por e njëjta ishte hedhur poshtë si e paafatshme. Për këtë arsye nuk ishte bërë përmbledhja e përmbajtjes së saj.

e) SM

9. Mbrojtësi Visar Vehapi paraqet se aktvendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me dispozitat e KPP-së dhe i propozon Gjykatës së Apelit ta hedh poshtë aktakuzën dhe ta ndërpres procedurën penale ndaj kësaj të pandehure. Ai paraqet me sa vijon:

- Hetimi ishte zgjeruar më 29 nëntor 2012 për të përfshirë këtë të pandehur. Arsyetimi në aktvendimin e kundërshtuar nuk është i saktë pasi që nuk mund të supozohet se ka pasur kryerje të veprës penale pa pasur aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente. Për këtë arsye vepra penale e nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore nuk mund ta 'ndërpres' afatin e parashkrimit pasi që kjo vepër penale nuk është provuar. Bile edhe nëse kjo nuk do të ishte çështja, për shkak se vendimet e të pandehurit janë të datave shkurt dhe qershor 2007, hetimi ishte iniciuar më shumë se 5 vjet më pas, d.m.th në nëntor 2012. Prandaj afati i parashkrimit për pikat 1, 2, dhe 5 ka skaduar.

- Për veprën penale të krimit të organizuar, vepra bazë medoemos duhet të jetë e dënueshme prej së paku 4 vjet burgim, dhe ai nuk pajtohet me interpretimin e dhënë nga kryetari i trupit gjykues mbi këtë çështje. Për më tepër, pasi që afati i parashkrimit ka skaduar për veprat bazë, atëherë pika 11 nuk mund të qëndrojë pasi që krimi i organizuar nuk është vepër e pavarur penale.

- Prokurori e ka akuzuar të pandehurën për katër vepra penale për të njëjtat veprime. Ky është cilësim kumulative juridik dhe për këtë arsye është i gabueshëm.

- E pandehura është i liruar nga ndjekja penale me nenin 107 të kushtetutës.

- Sa u përket pikave 1, 2 dhe 5, prokurori nuk e ka provuar qëllimin e të pandehurës për të siguruar dobi pasurore për veten ose të tjerët, ose që u ka shkaktuar dëm të tjerëve.

- Gjyqtarët ndonjëherë nxjerrin vendime të gabueshme. Vendimi i gabuar nuk paraqet vepër penale.

f) Prokurori special

10. Prokurori special pohon se ankesat janë kryesisht përsëritje e të gjitha argumenteve tashmë të sjella nga kryetari i trupit gjykues dhe shtynë Gjykatën e Apelit t'i refuzojë ankesat si të pabaza.

11. Prokurori special nuk pajtohet me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në një lëndë tjetër (PN 474/14 të datës 26 shtator 2014) lidhur me çështjen e hetimeve pas ngritjes së aktakuzës. Në aktvendimin e kundërshtuar, kryetari i trupit gjykues deklaroi se afatet kohore për hetime ekzistojnë me qëllim që të sigurohet se të pandehurit nuk do t'iu nënshtrohen hetimeve të gjata, për të cilat nuk janë të njoftuar, dhe prandaj nuk janë në dijeni rreth çfarëdo lënde që është duke u përgatitur kundër tyre. Megjithatë, në rastet kur është ngritur aktakuza dhe janë zbuluar të gjitha materialet provuese dhe dihen të gjitha akuzat. Të dyja palët vazhdojnë ta kenë mundësinë e mbledhjes së materialeve provuese dhe të vazhdimin të hetimeve me qëllim për t'i prezantuar

provat në gjykatë. Megjithatë, vendimi i Gjykatës së apelit e bën interpretimin e fazës së procedurës pas ngritjes së aktakuzës si parandalim të prokurorisë (dhe mbase gjithashtu edhe të mbrojtjes) për të mos vazhduar me hetimet deri në fillim të shqyrtimit gjyqësor kur mund të ketë kërkesa për aktvendime në pajtim me nenin 288 të KPP-së. Në bazë të këtij vendimi, kjo gjë do të thotë se ka një vakum në mes të këtyre dy ngjarjeve, gjatë së cilës kohë asnjë veprim hetimor nuk është i mundur qoftë nga palët apo nga gjyqtari. Prokurori special është i mendimit se ky interpretim është i paarsyeshëm dhe do ta dëmtonte koherencën e sistemit të drejtësisë penale. Në secilën fazë të procedurës duhet të ketë mundësi për zhvillim të procedurës penale me qëllim të sigurimit të provave të reja, të cilat do t'i prezantohen para gjykatës, apo të kërkesave që një gjë e tillë të bëhet nga ana e gjykatës.

12. Prokurori special pajtohet me kryetarin e trupit gjykues se nuk ka asnjë dispozitë e cila ia ndalon prokurorit kryerjen e veprimeve hetimeve pasi të jetë ngritur aktakuza, dhe se neni 244 (3) i KPP-së që parasheh zbulimin e “materialit të ri” është sqarues i qartë i qëndrimit në fjalë. Prokurori po ashtu vëren se neni 82.2 i Ligjit mbi bashkëpunimin ndërkombëtar juridik, i cili përcakton që kërkesat për asistencë juridike duhet të dorëzohen nga gjykata pas ngritjes së aktakuzës (dhe para ngritjes së saj, kur aktakuza dorëzohet nga ana e prokurorit të shtetit). Në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit, në mes të ngritjes së aktakuzës si dhe shqyrtimit gjyqësor është e mundur të merren prova jashtë Kosovës por një gjë e tillë është e ndaluar të bëhet brenda vendit – situatë kjo mjaft paradoksale.

13. Çështja në të vërtetë duhej të ishte kujt i lejohet të mbledhë prova: gjyqtarit apo palëve. Është e zakonshme për sistemet penale të cilat janë më të shpeshta në Evropë që gjyqtari ta bëjë këtë, por në sistemet me palë kundërshtare, pjesa më e madhe e këtyre kompetencave iu takon pikërisht palëve. Në KPP-në e re, përgjegjësia kryesore për mbledhjen e provave qëndron me palët, duke pasqyruar kështu karakterin në esencë të kundërshtimit të sistemit në fjalë. Prokurori special po ashtu vëren se avokatët mbrojtës iu kanë bashkëngjitur dokumentet kundërshtimeve të tyre ndaj provave / kërkesave për hedhjen poshtë të aktakuzës që ishin dorëzuar tek kryetari i trupit gjykues, gjë e cila ka mundësi të përfshihet si provë e dokumentuar në shqyrtimin gjyqësor.

14. Në fund, prokurori pajtohet me pikëpamjen e kryetarit të trupit gjykues se prokurori ka të drejtë të mbledhë prova edhe pas aktakuzës sepse nuk i ndalohej kjo gjë, dhe jo siç ishte pikëpamja e Gjykatës së Apelit në aktvendimin e saj të mëhershëm se atij i lejohet të bëjë këtë vetëm nëse ekziston ndonjë dispozitë specifike e cila lejon veprime të tilla.

g) Prokurori i apelit

15. Prokurori i apelit kërkon nga Gjykata e Apelit që t'i refuzojë ankesat dhe ta vërtetojë aktvendimin e kundërshtuar.

16. Prokurori i apelit vëren se pohime e bëra në ankesa tashmë janë ngritur edhe gjatë shqyrtimit fillestar dhe janë refuzuar si të tilla me aktvendimin e kundërshtuar në fjalë. Ai i referohet pjesës së arsyetimit të aktvendimit si dhe argumenteve të parashtruara nga prokuroria në përgjigje të kërkesave të mbrojtjes për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimeve të provave si dhe përgjigjes së prokurorit speciale në ankesat.

17. Neni 250 i KPP-së u lejon të pandehurve të parashtrorin kërkesë për hedhjen poshtë të aktakuzës për arsye specifike. Procedura nuk ka për qëllim të presë vlerësimin e provave, dhe më shumë është një procedurë verifikimi ashtu që lëndët me mungesa serioze dhe të pariparueshme të mos procedohen më tutje.

18. Prokurori i apelit konstaton se veprimet për të cilat akuzohen të pandehurit janë vepra penale në kohën kur pohohet se janë kryer dhe sipas ligjit penal aktualisht në fuqi. Pikat e aktakuzës në mënyrë të qartë i përmendin veprat penale në fjalë. Nuk ekzistojnë rrethana të cilat do ta përjashtonin përgjegjësinë penale të të pandehurve. Ka mjaft prova për mbështetjen e dyshimit të bazuar mirë siç pohohet në aktakuzë.

19. Pohimet lidhur me skadimin e afatit të parashkrimit tashmë janë adresuar, edhe pse prokurori i apelit nuk pajtohet me kryetarin e trupit gjykues se letra e mirëbesimit nuk e ndërpret afatin e parashkrimit.

20. Nuk ka rrethana të tjera të cilat do ta ndalonin ndjekjen penale dhe gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet në qoftë se kanë kryer shkelje të qëllimshme të ligjit.

21. Argumentet të cilat e shoqërojnë cilësimin juridik (*lex specialis*, konsumimi apo bashkimi i veprave) nuk janë arsye për hedhjen poshtë të aktakuzës në bazë të nenit 250 të KPP-së.
22. Lidhur me nenin 249 të KPP-së, prokurori i apelit e ndan të njëjtën pikëpamje sikur të kryetarit të kolegjit se KPP-ja nuk ia ndalon prokurorit t'i kryejë hetimet pas ngritjes së aktakuzës dhe se afati kohor prej dy vjetësh për hetime nuk kishte skaduar kur ishin marrë provat në fjalë.
23. Intervistat e tre dëshmitarëve janë kryer në bazë të nenit 131 të KPP-së, sipas të cilit prokurori i shtetit *mund* ta lejojë mbrojtjen që të marrë pjesë.
24. Në fund, sipas jurisprudencës përkatëse lidhur me çështjen e veprave penale bazë për akuzën e krimit të organizuar, shprehja 'së paku' në nenin 274 të KPP-së duhet të interpretohet me këtë domethënie "duhet patjetër të jetë e mundshme të zbatohet dënimi i përmendur në përputhje me ligjin".

III Të gjeturat e kolegjit

Kompetenca e kolegjit

25. Pasi që janë ushtruar ankesat, Gjykata Supreme e Kosovës ka lëshuar qarkuar e datës 9 janar 2015 me numër 12 / 2015 pas seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet të cilat lidhen me provat e marra me masa të fshehta. Njëra prej pyetjeve të adresuara në qarkore është procedura e apelit kundër aktvendimit me të cilin vendoset pranueshmëria e provave të siguruara përmes përdorimit të këtyre masave. Qarkorja jep këtë opinion:

Është e qartë se kur gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues e shpall një provë të papranueshme, i takon kolegjit shqyrtues për vëzhgim dhe hetime të vendosë për ankesën dhe jo Gjykatës së Apelit, siç ka qenë praktika e deritanishme në gjykata.

26. Kolegji konsideron se ky opinion është i pasaktë dhe bazohet në keqinterpretimin e neneve 97 dhe 98 të KPP-së. Kolegji është i bindur se funksioni kryesor i këtyre neneve është të përmbushen detyrimet pozitive për shtetin, të cilat caktohen me nenin 8 të Konventës Evropiane

mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kur një ligj vendor e zbaton institutin e sistemit të vëzhgimit, sipas të cilit të gjithë personat në vend kanë mundësi të preken nga zbatimi i masave në fjalë, atëherë ka mundësi të shkelen e drejta e individit në jetë private. KEDNJ-ja përcakton që duhet patjetër të ketë garanci efektive kundër abuzimit të mundshëm me të tilla masa.

27. Dispozitat e përgjithshme lidhur me pranueshmërinë e provave gjenden në nenin 249 të KPP-së dhe nenin 97, par. 3 të KPP-së dhe i përsëritin të njëjtat rregulla lidhur me provat e fituara përmes masave të fshehta: kundërshtimet (‘sfidimi’) duhet të bëhen para shqyrtimit të dytë dhe i takon gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues që të vendosë lidhur me propozimin në fjalë. Të dyja nenet përcaktojnë që vendimi në fjalë mund të apelohe.

28. Nuk ka asgjë në nenet 97 apo 98 të KPP-së që do të krijonte arsye për të besuar se procedura e ankesave kundër aktvendimit të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues duhet të dallojë nga procedura e përgjithshme në rastet kur provat e kundërshtuara janë fituar përmes masave të fshehta. Të dy nenet në fjalë i përmbushin obligimet e përkufizuara me KEDNJ dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ); lidhur me masat e fshehta duhet të ketë mekanizma efektive të kontrollit për të siguruar zbatimin e ligjit, dhe duhet të ketë një mekanizëm të pavarur mbikëqyrës nga ai i cili e zbaton masën. Së pari, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues në çfarëdo kohe para nxjerrjes së aktgjykimit të formës së prerë ta shqyrtojë *ex officio* pranueshmërinë e provave të siguruar sipas nenit 88 të KPP-së. Së dyti, procedura e mbikëqyrjes e përshkruar me nenin 98 të KPP-së është edhe një barrierë “plotësuese” mbrojtëse kundrejt masave të kundërligjshme të fshehta, të cilat mund të iniciohen nga cilado palë që konsideron se të drejtat e saja janë shkelur nga urdhri i caktuar apo zbatimi i tij.

29. Se neni 98 i KPP-së nuk me merret me procedurën e ankesave kundër aktvendimeve mbi pranueshmërisë e provave, po ashtu mund të shihet edhe në nenin 98, par. 4 të KPP-së, i cili përcakton se në rastet kur urdhri për masat e fshehta (apo zbatimi i tij) është vërtetuar si i kundërligjshëm me aktvendim të formës së prerë, atëherë ky aktvendim është detyrues për kolegjin shqyrtues për vëzhgim dhe hetime. Kjo gjë demonstroi se këto dy procedura janë të ndara. Nuk ka asgjë që do të tregonte se ligjvënësi i KPP-së ka pasur për qëllim të krijojë

procedura jopraktike dhe jofunksionale duke i ndarë pasqyrën mbi pranueshmërinë e provave në dy procedura të ndryshme në shkallën e apelit dhe për më tepër, në dy gjykata të ndara.

30. Kolegji përfundon se ankesa kundër pranueshmërisë së provave të siguruara me masa të fshehta teknike duhet të gjykohet sipas neneve 249, par. 6 dhe 408 të KPP-së, nga ana e Gjykatës së Apelit, prandaj kolegji është kompetent për t'i trajtuar ankesat në të gjitha pjesët e tyre.

Çështjet e pranueshmërisë

31. Ankesa e parashtruar më 25 shtator 2014 nga mbrojtësi Visar Vehapi në emër të të pandehurës **SM** është e afatshme dhe e pranueshme.

32. Avokati mbrojtës Selatin Ahmeti për të pandehurin **FH** ka parashtruar ankesa më 15 shtator 2014 dhe më 8 tetor 2014. KPP-ja nuk parasheh ankesa të dyta të cilat parashtrohen pas afatit kohor të lejueshëm. Nëse palëve iu lejohet një gjë e tillë atëherë do të humbej plotësisht qëllimi i afateve rigoroze në procedurën e apelit. Ankesa e dytë prandaj hedhet poshtë si e paafatshme. Ankesa e parashtruar më 15 shtator 2014 është parashtruar me kohë dhe është e pranueshme.

33. Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit **NU** më datën 12 shtator 2014. Më 24 tetor 2014 është paraqitur një 'plotësim' i ankesës në fjalë. KPP-ja nuk parasheh plotësime të ankesave të cilat parashtrohen përtej afatit kohor të lejueshëm. Nëse palëve iu lejohet një gjë e tillë atëherë do të humbej plotësisht qëllimi i afateve rigoroze në procedurën e apelit. Për këtë arsye, 'plotësimi' në fjalë hedhet poshtë si ankesë e paafatshme. Ankesa e parashtruar më 12 shtator 2014 është e afatshme dhe e pranueshme.

34. Mbrojtësi Zivojin Jokavovic ka parashtruar ankesë me afat për **MHB** më 12 shtator 2014. Kjo ankesë mbështetet nga autorizimi i nënshkruar më 11 shtator 2014. Të njëjtën ditë edhe vetë e pandehura **MHB** po ashtu ka paraqitur ankesë në ankesën e përbashkët të parashtruar nga mbrojtësit Xhevat Bici, Haxhi Kelmendi, Bajram Tmava, Qerim Metaj, Qazim Qerimi dhe Selman Bogiqi. Kjo ankesë e përbashkët është parashtruar me afat dhe është e pranueshme.

Të gjeturat mbi meritat

35. Kolegji i Gjykatës së Apelit së pari vëren se mundësia për të parashtruar kundërshtime ndaj provave dhe kërkesave për hedhjen poshtë të aktakuzës duket se është keqkuptuar në mesin e mbrojtësve si një lloj gjykimi paraprak duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion. Kjo fazë e procedurës penale ka si qëllim të vendosë një filtër të ashpër vetëm ndaj akuzave të gabueshme dhe tërësisht të pabaza. Ndërsa nëse futemi në detaje më të hollësishme rreth pranueshmërisë së provave dhe të cilësimit juridik të akuzave, kjo i takon kolegjit të shqyrtimit gjyqësor dhe jo fazës së ngritjes së aktakuzës.

36. Kolegji vëren se shumë prej argumenteve kanë të bëjnë me vlerësimin e provave. Qëllimi i një ankese sipas neneve 249 dhe 250 të KPP-së, nuk është të kërkohet nga Gjykata e Apelit të bëjë vlerësimin e plotë të provave. Detyrë e kolegjit është të jetë i bindur për vërtetimin e dyshimit të bazuar mirë, siç kërkohet me ligj, dhe nëse lënda në fjalë duhet të shkojë në gjykim apo jo. Nëse lënda shkon në gjykim, atëherë vlerësimi i plotë i provave dhe vërtetimi i gjendjes faktike është detyrë e trupit gjykues. Kolegji, konstaton, prandaj se nuk është e domosdoshme të kryhet një vlerësim i tillë me qëllim të vërtetimit të ekzistimit të dyshimit të bazuar mirë.

Ligji është i qartë në atë se mbrojtja mund të parashtrorë kundërshtime ndaj provave vetëm për shkaqet e përmendura në nenin 249, par. 1 të KPP-së. Asnjë prej mbrojtësve në mënyrë specifike nuk ka pretenduar ndonjë prej këtyre arsyeve. Kjo është çështje e ndryshme prej besueshmërisë së dëshmitarëve dhe vërtetimit të vlerës së provave në raport me epilogun e lëndës.

37. Kolegji po ashtu vëren se në ankesa shumë pak çështje janë ngritur e që nuk janë ngritur në kundërshtimet e bëra ndaj provave dhe kërkesës për hedhjen poshtë të aktakuzës, të cilat i janë parashtruar kryetarit të trupit gjykues. Kolegji e gjen se aktvendimi i kundërshtuar është i arsyetuar mirë dhe iu përgjigjet të gjitha parashtrësve. Duke e pasur parasysh këtë, avokatët mbrojtës për të pandehurit **NU** dhe motrat parashtrorë në ankesat e tyre se kryetari i trupit gjykues nuk iu është përgjigjur të gjitha pohimeve të bëra nga mbrojtja dhe nuk i ka cekur arsyet për refuzimin e kundërshtimeve të mbrojtjes lidhur me provat dhe kërkesat e tyre për hedhjen poshtë të aktakuzës. Megjithatë, asnjë shembull konkret nuk jepet lidhur me ndonjë prej këtyre pikave të cilat ata i kishin ngritur e që nuk kishin marrë asnjë përgjigje, ndërsa pikëpamja e kolegjit është se kryetari i trupit gjykues i ka adresuar të gjitha argumentet përkatëse dhe ka

dhënë arsye shumë të qarta për refuzimin si të pabazuara të të gjitha kërkesave të parashtruara nga ana mbrojtëse.

38. Zgjedhja e prokurorit lidhur me cilësimin juridik të veprave në aktakuzë është ngritur në mënyra të ndryshme nga mbrojtësit. Mbrojtësi Tahir Rrecaj për të pandehurin **NU** pohon se cilësimet juridike të veprave janë të pakuptimta. Kolegji vëren se prokurori është i obliguar të japë në hollësi veprat penale në aktakuzë. Përderisa pajtohet se këto cilësime nuk janë gjithaq të qarta në të gjitha pjesët e tyre, ato janë të pranueshme në këtë fazë të procedurës dhe se veprat janë përshkruar në mënyrë të mjaftueshme dhe të detajuar ashtu që të pandehurit të mund të përgatitin si duhet dhe në mënyrë të plotë mbrojtjen e tyre për fazën e shqyrtimit gjyqësor. Përndryshe, mbrojtësit mund t'i propozojnë trupit gjykues sqarimin e çfarëdo çështjeje në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, është gjithashtu edhe detyrën e trupit gjykues që të ngre për diskutim çfarëdo çështje të cilën ata e konsiderojnë të rëndësishme për cilësimin juridik të akuzave në fjalë me qëllim të gjyqimit të drejtë. Roli i Gjykatës së Apelit nuk është për të vendosur cilësimet juridike përfundimtare, por për të siguruar se aktakuza nuk ka defekte të tilla saqë mos mund të procedojë tutje në shqyrtimin gjyqësor. Në fund, në rast të çfarëdo dënimi, është në dorë të trupit gjykues, në përputhje me nenin 241, par. 1, pikën 4 të KPP-së, për të përcaktuar cilësimin / cilësimet përfundimtare juridike me të cilat është bërë klasifikimi i veprave penale në fjalë. Kjo është e qartë se përshin në vete edhe vërtetimin se si duhet të ndahen veprat penale në pika të veçanta të aktakuzës, nëse një gjë e tillë është e nevojshme të bëhet.

39. Avokatët mbrojtës për të pandehurit **NU** dhe motrat kanë theksuar se kryetari i trupit gjykues gabimisht ka vendosur të vërtetojë se cili kod penal është i zbatueshëm në këtë lëndë dhe në këtë fazë të procedurës, dhe se kjo është relevante për statusin e afateve të parashkrimit. Përndryshe, të gjitha ankesat theksojnë se afati i parashkrimit e ndalon ndjekjen penale. Kolegji pajtohet me kryetarin e trupit gjykues se nuk afat kohor që e ndalon ndjekjen penale për çfarëdo vepre penale të cilën e përmban aktakuza. Kryetari i trupit gjykues është futur në detaje të konsiderueshme lidhur me atë se për çfarë arsye kishte arritur në këtë lloj konkluzioni, dhe se kolegji nuk gjen asnjë gabim në analizën e tij të çështjes në fjalë dhe të arsyetimit.

40. Çështja e hetimeve pas ngritjes së aktakuzës është interpretuar në mënyrë të ndryshme. Kolegji e ka shqyrtuar arsyetimin dhe konkluzionet në aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN 474/14, të datës 26 shtator 2014, por konstaton se nuk janë në përputhje me njëri tjetrin. Kolegji, në të vërtetë, është i bindur me argumentet e parashtruara nga prokurori special në përgjigjen e tij ndaj ankesave të cilat adresonin interpretimin ligjor në këtë pikë. Duke e bërë një gjë të tillë, kolegji gjithashtu pajtohet me arsyetimin e kryetarit të trupit gjykues. Nuk ka ndonjë ndalesë ligjore për hetimet pas ngritjes së aktakuzës, dhe kolegji prandaj konsideron se nuk ka shkelje të të drejtave të pandehurit apo të korrektësisë së procedurës përderisa ndjekja penale i përmbush detyrimet e përcaktuara me KPP lidhur me zbulimin e informatave për palën mbrojtëse. Si përfundim, kolegji nuk gjen ndonjë mospërputhje me të drejtat e njeriut të garantuara me KPP, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës apo me konventat ndërkombëtare.

41. Avokati mbrojtës për të pandehurin **NU** deklaron se janë shkelur nenet 131 dhe 132 të KPP-së. Kolegji vëren se arsyetimi i kryetarit të trupit gjykues në këtë pikë lidhur me paragrafët 38 dhe 44 të aktvendimit të kundërshtuar, si dhe është në pajtim të plotë me analizën ligjore të çështjes në fjalë, e cila është theksuar në mënyrë shumë të qartë. Avokati mbrojtës po ashtu parashtron se për veprën penale të mashtrimit duhet patjetër të ketë dëme konkrete materiale, që në rastin në fjalë mungojnë. Kjo vërejtje është adresuar në mënyrë të qartë nga kryetari i trupit gjykues, i cili në mënyrë të hollësishme ka shpjeguar si dhe ku qëndrojnë dëmet në fjalë. Avokati mbrojtës po ashtu ofron shembuj të asaj çfarë ai e konsideron të jenë karakteristika të grupit të organizuar kriminal, dhe pastaj pretendon se të njëjtat karakteristika mungojnë në lëndën në fjalë. Kolegji konstaton se një interpretim i këtillë duket se është pikëpamje personale e avokatit përkatës mbrojtës, i cili si i tillë nuk mbështetet me përkufizimin e bërë në kodin penal as nuk nga mbrojtësi në fjalë nuk është cituar kurrfarë jurisprudence për ta mbështetur një pretendim të tillë.

42. Avokatët mbrojtës të motrave pretendojnë se vepra penale e legalizimit të përmbajtjeve të pavërteta duhet patjetër të bazohet në ndonjë dokument të falsifikuar. Kolegji pajtohet me kryetarin e trupit gjykues se një gjë e tillë nuk është kusht sipas nenit 334 të ish-KPK-së.

43. Mbrojtësi i të pandehurës **SM** deklaron se e pandehura në fjalë ka imunitet ndaj ndjekjes penale duke u bazuar në nenin 107 të Kushtetutës. Megjithatë, është e qartë se neni në fjalë i

mbron vetëm gjyqtarët derisa janë duke i kryer funksionet e tyre gjyqësore, dhe nuk ka si qëllim të ofrojë mbrojtje nga ndjekja penale për gjyqtarët e angazhuar në aktivitete kriminale. Ai po ashtu parashtrohet se lidhur me pikat e aktakuzës 1, 2 dhe 5, prokurori nuk e ka provuar qëllimin e të pandehurit për të përfituar dobi pasurore për vete apo për të tjerët ose për t'i shkaktuar dëme dikujt tjetër. Megjithatë, është e qartë se aktakuza jep në detaje lëndën e prokurorisë, që i bie se një gjë e tillë shkon në favor të familjes **H – U**.

44. Në përmbledhje, kolegji konstaton se aktakuza nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të proceduar më tej në shqyrtimin gjyqësor, dhe i plotëson kushtet e domosdoshme në mënyrë që pandehurit të jenë në gjendje të përgatitën mbrojtjen e tyre për shqyrtimin gjyqësor.

45. Gjykata e Apelit konstaton se kryetari i trupit gjykues ka bërë një vlerësim të saktë dhe i ka dhënë arsyet e mjaftueshme për të konstatuar se provat arrijnë vlerën e dyshimit të bazuar mirë. Siç është theksuar edhe më lart, nuk ka nevojë për vlerësim të detajuar as nuk është e mundur të bëhet një gjë e tillë qysh në këtë fazë të procedurës, dhe kjo i takon trupit gjykues që ta bëjë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

46. Përkitazi me kërkesën e motrave për heqjen e ndalesës për tërheqjen e parave nga xhironlogaritë bankare, kolegji në fjalë konsideron se kjo është kërkesë për ndërprerjen e urdhrin ndalues të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake më 18 prill 2013. Një vendim i këtillë është vërtetuar pas parashtrimit të ankesës, përmes aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN 356 / 13, të datës 17 maj 2013, prandaj për këtë arsye ky vendim edhe është vendim i formës së prerë. Si i tillë, vendimi në fjalë nuk mund të ankimohet më tutje prandaj kërkesa në fjalë hedhet poshtë si e palejueshme. Çfarë çështje e cila ka të bëjë me urdhrin ndalues afatgjatë duhet prandaj t'i adresohet Gjykatës Themelore.

47. Kolegji ka marrë vendimin në bazë të nenit 413 të KPP-së, duke u mbështetur vetëm në ankesat dhe propozimet e parashtruara. Çështjet e trajtuara në ankesë janë të qarta, duke e bërë të panevojshme mbajtjen e seancës së kolegjit, e cila përcaktohet sipas nenit 413, par. (2) të KPP-së.

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtëse

Kryetar i kolegjit

Kerry Kirsten Moyes

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Timo Vuojolahti

Gjyqtar i EULEX-it